



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 16180/11 Prot.,

Shkodër, më 19.08.2024

KONTRATË SHERBIMI  
REF-12532-07-09-2024

**Projektim i objektit: Sistemim asfaltim rruga 'Pjetrushë' pranë varrezave të qytetit Grudë e Re**

E lidhur sot me datë \_\_\_/\_\_\_/2024, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga **Z. Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr. 541 datë 02.07.2024 nga **Z. Onid Bejleri** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

**Dhe** operatorit ekonomik "NOVATECH STUDIO" sh.p.k regjistruar me regjistrim fillestar me nr. CN-392993-05-10 me license profesionale të shoqërisë Nr.6389/10 date 19.11.2020 me vlefshmeri të licenses deri me date 01.01.2025 leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe e Energjiise me seli te shoqerise: Njesia bashkiake nr 8, rruga Shenasi Dishnica, hyrja 1, ap 18 – Tirane, me NUIS L01717030C, e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **Z. Emil Nova** me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet "**Kontraktuesi**"

**Neni 1**

**Baza ligjore**

- Kodi Civil ligji nr.7850, dt. 29.07.1994, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar
- VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",i ndryshuar
- Vendim nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime ne Planifikim Terriori,Projektim,mbikqyerje dhe Kolaudim" I ndryshuar.
- Ligji nr.48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar.
- VKM nr. 9, datë 11.01.2024 "Për Miratimin e Rregullave Për Projektet që Duhet tiNënshtrohen Oponencës Teknike Sipas Secilës Fushë Projektimi, Si dhe Procedurat që Ndiqen në Këto Raste."



## Neni 2

### Objekti i kontratës

- 2.1. Objekt i kësaj kontrate është shërbimi i projektimit për objektin: **”Projektim i objektit: Sistemim asfaltim rruga ‘Pjetrushë’ pranë varrezave të qytetit Grudë e Re”** në përputhje me të gjitha termat e referencës dhe detyrës së projektimit të dhëna në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi “NOVATECH STUDIO”**, pranon t’i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit. Kontraktuesi pranon të gjitha termat e procedurës së prokurimit me firmosjen e kësaj Kontratë.

## Neni 3

### Vlefë e kontratës

- 3.1. Kontraktuesi merr përsipër të kryejë të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha termat e referencës dhe detyrën e projektimit të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere prej **705,613** (shtatëqind e pesë mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh dhe **846,735.60** (tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë) lekë me tvsh.
- 3.2. Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkisë viti 2024 i miratuar me VKB nr.55 datë 29.12.2023 ”Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2024 - 2026 të Bashkisë së Shkodrës.
- 3.3. Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

## Neni 4

### Afati i kontratës

- 4.1 Kontrata do të realizohet brënda **60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike** nga nënshkrimi mes paleve të procesverbalit të fillimit të shërbimit.

## Neni 5

### Gjuha e kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

## Neni 6

### Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës e hapur e thjeshtuar.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mbron në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.



- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

## Neni 7

### Dispozitat e përgjithshme

#### 7.1 Përkufizimet

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

##### 7.1.1 Kontrata

- 7.1.1.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.
- 7.1.1.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- 7.1.1.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
- 7.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- 7.1.1.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- 7.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- 7.1.1.7 "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- 7.1.1.8 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuar nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumentet



të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

**7.1.1.9** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

**7.1.1.10** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

**7.1.1.11** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## **7.1.2 Palët e Kontratës**

**7.1.2.1** "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

**7.1.2.2** "Blerës" do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.

**7.1.2.3** "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimine Shërbimeve objekt kontrate.

**7.1.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

## **7.1.3 Llogaritja e afateve**

**7.1.3.1** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

## **7.1.4 Shërbimet**

**7.1.4.1** "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

## **7.1.5 Përkufizime të tjera**

**7.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

**7.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".

**7.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".

**7.1.5.4** "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

**7.1.5.5** "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

**7.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.

**7.1.5.7** "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.



7.1.5.8 "Praktikat e Ndaluar" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

## 7.2 Interpretimi

7.2.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- (a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- (b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
- (c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

### 7.2.2 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

### 7.2.3 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

### 7.2.4 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

## 7.3 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rena dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:



(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

#### **7.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruar nga Furnizuesi.

#### **7.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

#### **7.6 Hartimi i Kontratës**

**7.6.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

**7.6.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

#### **7.7 E drejta e autorit**

**7.7.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë palë të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.



## 7.8 Detaje Konfidenciale

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

## 7.9 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) të këtij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha



detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

#### **7.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

#### **7.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluar, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 8**

#### **Praktikat e Ndaluar**

**8.1** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluar në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

**8.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

### **Neni 9**

#### **Njoftimet**

**9.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

**9.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

### **Neni 10**

#### **Objekti i Furnizimit**

**10.1** Shërbimet që do të furnizohen duhet të jenë sipas termave të referencës dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.





- 10.2 Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 11**  
**Dorëzimi**

- 11.1 Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 12**  
**Përgjegjësitë e Furnizuesit**

- 12.1 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 13**

**Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit**

- 13.1 Furnizuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.

- 13.2 Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigura.

- 13.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

- 13.4 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

**Neni 14**

**Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit**

- 14.1 Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.

- 14.2 Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

- 14.3 Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.



Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

### **SHËRBIMET E KËRKUARA**

Grupi i projektimit është i detyruar të bashkëpunojë ngushtë me Strukturat e Pushtetit Vendor si dhe me subjekte të tjera që paraqesin interes për zgjidhjen e projektit me qëllim për të siguruar azhurnimet aktuale për paraqitjen e varianteve më të përshtatshme, për plotësimin me elementet e nevojshëm të infrastrukturës, për plotësimin e dokumentacionit të shpronësimeve dhe miratimet ligjore në organet përkatëse. Gjithashtu Grupi i projektimit duhet të mbështetet dhe të konsultohet me studimet dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, në rast se do propozojë modifikime nga gjurma ekzistuese.

#### **Shërbimi i kërkuar do të përfshijë por jo të limitohet në:**

- Kryerjen dhe studimin e plotë për të gjetur alternativën tekniko-ekonomike-mjedisore më të mirë, për të ndërtuar një segment rrugor sipas standardeve shqiptare.
- Analiza e detyrës së projektimit që do të përfshijë rekomandime të qarta për çdo fazë të hartimit të projektit.
- Mbledhja, azhurnimi dhe analizimi i rrjetit të infrastrukturës me të gjitha të dhënat e nevojshme për projektim siç janë gjendja ekzistuese e kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, rrjeti i telefonisë do të merren tek institucionet përkatëse;
- Rilevimi i zonës për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektimit që të evitohen pasaktësitë;
- Hartimi i analizës së kostove dhe përfitimeve për secilin variant;
- Kompletimi i projekt idesë paraprake për alternativat e përzgjedhura;
- Trajtimi i projektit nga pikëpamja teknike (mjedisore, inxhinierike, gjeoteknike, ekonomike, planifikimit të trafikut, sigurisë rrugore, etj.);
- Paraqitja e një programi për realizimin e projekt idesë paraprake, projekt idesë përfundimtare, projektit të zbatimit, dokumentacionin për tenderimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për leje ndërtimi;
- Grupi i projektimit sipas fazave të projektit të përcaktuara më poshtë do të analizojë dhe të japë të dhëna të hollësishme për shpronësimet e tokës apo objekteve duke dhënë të qarta kufijtë e shpronësimeve dhe llogaritjet e sipërfaqeve sipas pronarëve duke u mbështetur dhe bashkëpunuar me ASHK dhe Pushtetin Lokal.

#### **Fazat e projektit do të jenë si më poshtë:**



**Faza I.** Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit;

**Faza II.** Projekt ideja paraprake;

**Faza III.** Projekt ideja përfundimtare;

**Faza IV.** Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit;

**Faza V.** Projekti i zbatimit;

**Faza VI.** Preventivi përfundimtar;

**Faza VII.** Miratimi i oponencës teknike; Secila nga këto faza duhet të bëhet në konsultim të vazhdueshëm me stafin e Bashkisë Shkodër.

## **FAZA I : ANALIZA E DETYRËS SË PROJEKTIMIT DHE PËRCAKTIMI I BAZËS SË PROJEKTIT**

Detyrat më kryesore që do të përfshihen gjatë kësaj faze janë si më poshtë: – Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit;

– Rishikimi dhe vlerësimi i të dhënave ekzistuese, informacionet, fotografi ajrore, harta dhe njohuri nga të gjitha fushat kryesore nëpërmjet një studimi të të dhënave ekzistuese dhe inspektimi të detyrueshëm në terren nga ana e grupit te projektimit;

– Analizimi i informacionit të mbledhur për të gjitha fushat kryesore (mjedisin, gjeologjinë, topografinë, sigurinë rrugore, vëllimin e trafikut, etj.);

– Kryerja e kërkimeve shtesë që nevojiten për të plotësuar mungesat në informacionin që kërkohet për marrjen e vendimeve të sakta;

– Trajtimi i projektit nga pikëpamja teknike (mjedisore, inxhinierike, gjeoteknike, ekonomike, planifikimit të trafikut, sigurisë rrugore, etj.);

– Paraqitja e një programi për realizimin e projekt idesë paraprake, projekt idesë përfundimtare, tenderimin e punimeve dhe ndërtimin e veprës;

– Dhënia e rekomandimeve.

## **FAZA II: PROJEKT IDEJA PARAPRAKE**

Në këtë fazë grupi i projektimit duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante të rrugës por duke mos e kufizuar atë për të studiuar dhe paraqitur dhe variante apo nën variante tjera që ai do t'i shohë të arsyeshme ti paraqesë.

– Vlerësimi dhe paraqitja e varianteve të ndryshme;

– Grupi i projektimit do te paraqesë për çdo variant avantazhet dhe disavantazhet duke dhëne dhe mendimin e tij për variantin qe ai përcakton më të arrirë;

– Paraqitja e një koncepti planifikimi, përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme të varianteve të paraqitura;

– Hartimi i analizës së kostove dhe përfitimeve për secilin variant;

– Dhënia e rekomandimeve. Përveç sa më sipër, grupi i projektimit duhet të përgatisë dokumentet e mëposhtme:

– Projekti ideja paraprake për rrugë të re ose përmirësim të rrugës ekzistuese do të zhvillohet në detaje të mjaftueshme për të nxjerrë vlerësimet e kostos



reale. Standardet e përgjithshme të projektimit të miratuara do të jenë në përputhje me standardet e projektimit dhe ligjet në Shqipëri.

– Seksionet tërthore të reja të rrugës ose ato të përmirësuara do të marrin aprovimin, së bashku me të gjitha detajet e tjera ndërtimore që kanë një ndikim të rëndësishëm të kostos, të tilla si rrjeti i kanalizimeve K.U.B, K.U.Z. ujësjellësi, ndriçimi rrugor.

– Projekti ideja paraprake duhet të trajtojë: sistemin kanalizimeve të ujërave të zeza; sistemin kanalizimeve të ujërave të bardha; shtresat rrugore; rrjetin e ujësjellësit; sistemin e ndriçimit rrugor; rrjetin i furnizimit me energji elektrike dhe rrjetin e telekomunikacionit; gjelbërimin, rrjetin i sinjalistikës; shpronësimet dhe sigurinë rrugore.

– Studimi gjeologo-inxhinierik;

– Raporti i Studimit hidrologjik dhe klimaterik;

– Llogaritja e elementëve të veçantë;

– Analiza e kostos paraprake. Kjo analizë paraqet llogaritje krahasuese për disa mundësi zgjedhesh, duke përfshirë dhe shpronësimet në qoftë se ka.

### **FAZA III: PROJEKT IDEJA PËRFUNDIMTARE**

Me plotësimin e të gjithë dokumentacionit mbështetës si dhe bazuar në variantin përfundimtar të miratuar të projekt idesë, grupi i projektimit do të hartojë projekt ide-në përfundimtare, e cila duhet të trajtojë detajet si më poshtë:

– Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamendësimeve të bëra gjatë fazave më të mëparshme;

– Përditësimin e llogaritjeve dhe zëvendësimin e hamendësimeve të bëra më parë;

– Përgatitjen e metodologjisë së përgjithshme të ndërtimit;

– Përgatitjen e programit të punimeve;

– Përgatitjen e vlerësimit të kostos duke krahasuar variantet;

– Ndikimet ndaj mjedisit;

– Projekt – ideja përfundimtare duhet që të paraqesë në formë të përgjithshme zgjidhjet përfundimtare të varianteve të propozuara të projektit;

Mbi sa më sipër grupi i projektimit gjatë kësaj faze do të përgatisë dhe të paraqesë për miratim studimet që vijojnë;

– Raporti i llogaritjes së Shtresave Rrugore,

– Raporti i Shpronësimeve. (Ky raport do të paraqesë një listë të mundshme shpronësimesh së bashku +me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotësohen në lidhje me projektin. Lista do të përmbajë sipërfaqen e tokës apo objekteve ndërtimore ku do të kryhet vlerësimi i kostos së pronave private të cilat preken nga projekti.)

– Studimi gjeologo-inxhinierik. (Ky studim do të paraqesë rezultatet ekzistuese të përfituara prej shpimeve apo mostrave të materialeve të nxjerra gjatë fazës



së projekt-idesë duke marrë parasysh dhe studimet e bëra në projekte të mëparshëm.)

– Vlerësimi i ndikimit në mjedis. (Sipas ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, do të kryhet raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.)

**FAZA IV: PROJEKTI PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT**  
Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore të sistemit të lejeve sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (si në nivel vendor ashtu dhe atë qendror). Grupi i projektimit duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar marrjen e të gjitha llojeve të lejeve që mund të nevojiten, sikurse plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për lejet respektive.

#### **FAZA V : PROJEKTI I ZBATIMIT**

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar, grupi i projektimit do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për të ndërmarrë procesin e tenderimit dhe të ndërtimit të objektit, i cili përgjithësisht duhet të përmbajë por jo të kufizohet në:

– Përgatitja projektit përfundimtar, vizatimet dhe vlerësimin e kostos, detajimeve të nevojshme, specifikimeve teknike, etj. Në këtë dokumentacion do të përfshihet puna e plotë, civile, arkitektonike, strukturore, mekanike, elektrike, sinjalistika dhe siguria rrugore, detaje të projektimit dhe vizatime për të gjitha komponentët e punës për realizimin e projektit pa nevojën e modifikimeve të mëvonshme.

– Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim, vizatime të detajuara shoqëruar me relacionin përkatës.

– Paraqitja e raporteve përfundimtare si: Raporti i Studimit Topografik, Raporti i Studimit Gjeoteknik, Raporti i Studimit Hidrologjik e Klimaterik, Raporti i Llogaritjes së Shtresave Rrugore, Raporti i Studimit Gjeologo-inxhinierik. – Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit.

– Azhurnimi i vazhdueshëm i projektit gjatë fazës së zbatimit.

#### **FAZA VI: PREVENTIVI PËRFUNDIMTAR**

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit, grupi i projektimit do të hartojë një liste me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi). Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë ato njësi të miratuara në VKM nr. 216, datë 13.4.2023. Zërat e punimeve që për ndonjë arsye nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar do të shoqërohen me analizën e llogaritjes të çmimit.

#### **FAZA VII: MIRATIMI I OPONENCËS TEKNIKE**



Detyrat kryesore, të grupit të projektimit, që do të përfshihen gjatë kësaj faze janë:

- Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e oponencës teknike për projektet infrastrukturore, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 9, datë 11.1.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, pranë institucionit që është përgjegjës për kryerjen e oponencës teknike;
- Ndryshimi i dokumenteve sipas kërkesës të institucionit përgjegjës për kryerjen dhe miratimin e oponencës teknike. Çdo ndryshim që lind si nevojë e plotësimit të kushteve për miratimin e oponencës, duhet të miratohet paraprakisht nga Bashkia Shkodër.

## **6. PARAQITJE E DOKUMENTACIONIT**

I gjithë dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) dhe VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” (i ndryshuar), për pajisjen me leje ndërtimi.

**I gjithë projekti duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:** –

Deklaratat e projektuesve të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;

– Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet,

– Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale; Projekti përfundimtar i zbatimit duhet të përmbajë minimumi raportet si më poshtë (formati A4):

– Raporti përfundimtar i studimit Topografik të zonës;

– Raporti përfundimtar i studimit Gjeologjiko-inxhinierik;

– Raporti përfundimtar i studimit Hidrologjik dhe Klimaterik si dhe llogaritjet hidraulike;

– Raporti përfundimtar i Shpronësimeve ku paraqiten ekstraktet kadastrale nga rregjistrat ose dokumente të tjera zyrtare;

– Llogaritjet e veprave të artit të firmosura nga inxhinieri;

– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (Në rastet kur kërkohet miratimi i Ministrisë së Mjedisit për VNM Paraprake/Thelluar të dorëzohet dokumentacioni i plote në përputhje me Ligjin Nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar);

– Raporti teknik përfundimtar;



- Specifikimet teknike;
- Grafiku i punimeve;
- Preventivi përfundimtar;

**Projekti përfundimtar i zbatimit duhet të përmbajë minimumi fletët (minimalisht format A3) si më poshtë:**

- Horografia ne shkallen 1:1000. Në raste që zona e studimit është shume e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkalle të përshtatshme;
- Harta e rievimit topografik, SH 1:500;
- Planimetritë e shpronësimeve SH 1:500;
- Planimetri e hollësishme e rrugës në shkallë 1:100;
- Profil gjatësor i rrugës, SH 1:100 V 1: 100;
- Profile tërthor të rishikuar të rrugës çdo 25 m si dhe në vendet me karakteristika te veçanta si, kryqëzime etj., SH 1: 100;
- Profile tërthor tip së bashku me të gjitha hollësitë e nevojshme, SH 1:25;
- Vizatimet e tombinove (llojet vendndodhja numri pjerrësia), SH 1:50;
- Planimetri për kryqëzimet dhe detaje përkatëse SH 1:200;
- Projekti elektrik ku të përfshihet: planimetria e ndriçimit dhe detaje të ndriçimit të sheshit, relacioni firmosur nga inxhinieri elektrik;
- Harta hidrologjike e rishikuar ku të tregohen qartë rrjedhjet ujore, SH 1:1000;
- Harta gjeologjike së bashku me planimetrinë e rrugës (shoqëruar me detaje gjeoteknike të disponueshme), SH 1:1000; apo veprave të artit;
- Plani i sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale të propozuar, SH 1:100;
- Vizatime të mureve mbajtës apo pritës (së bashku me përforcime) n.q.s. ka, SH 1:50;
- Punime suplementare dhe ndihmëse (këtu mund të përfshihen vend pushime anësore, rrugë shërbimi pajisjet rrugore, punime spostimesh, instalime të linjave nëntokësore apo mbitokësore, rrethimet elemente të drenazhimit, etj.), shkalla e vizatimeve të përshtatet me detajet që paraqiten;
- Zonat ku do të merren materialet e ndërtimit lëndë e parë përfshirë dhe punimet e përkohshme vendet e depozitimeve etj., SH 1:1000;

**STANDARDET NË PROJEKTIM**

Projekti duhet të hartohet mbështetur në zbatim të akteve ligjore apo nënligjore në fuqi për Kushtet Teknike të Projektimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE – së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim, te cilat nuk bien në kundërshtim me legjislacionet në fuqi. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare, si dhe kufizimet për financimin e



veprës. Projektuesit gjatë procesit të projektimit, duhet të zbatojnë: - Normat dhe standardet e projektimit e zbatimit sipas legjislacionit në fuqi; - Normat dhe standardet PAK; - Praktikrat më të mira evropiane

#### **Neni 15**

##### **Çmimi i Kontratës**

- 15.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

#### **Neni 16**

##### **Kushtet e Pagesës**

- 16.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK. Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.
- 16.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkesë për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.
- 16.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.
- 16.4** Në rast të verifikimit të vonësive në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

#### **Neni 17**

##### **Sigurimi i Kontratës**

- 17.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
- 17.2** Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.
- 17.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.
- 17.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

#### **Neni 18**

##### **Nënkontraktimi**

- 18.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.





- 18.2 Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për shërbimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.
- 18.3 Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

### **Neni 19**

#### **Specifikime dhe Skicime**

- 19.1 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.
- 19.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjese përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

### **Neni 20**

#### **Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

- 20.1 Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 20.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.


### **Neni 21**

#### **Dëmet e likujduara**

- 21.1 Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

### **Neni 22**

#### **Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**



- 22.1** Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.
- 22.2** Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 22.3** Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 22.4** Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

### **Neni 23**

#### **Zhdëmtimi i Patentës**

- 23.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që pëmdryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:
- (a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;
- dhe
- (b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.
- Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.
- 23.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.
- 23.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.
- Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.



Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

#### **Neni 24**

##### **Kufizimi i Përgjegjësisë**

- 24.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:
- (a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe
  - (b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

#### **Neni 25**

##### **Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

- 25.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

#### **Neni 26**

##### **Forca madhore**

- 26.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.
- 26.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.



- 26.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

#### **Neni 27**

#### **Modifikimi i Kontratës**

- 27.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.
- 27.2** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përlogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.
- 27.3** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

#### **Neni 28**

#### **Zgjatja e afatit**

- 28.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.
- 28.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

#### **Neni 29**

#### **Ndërprerja e Kontratës**

- 29.1 Njoftim për të korigjuar**  
Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund të kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
- 29.2 Ndërprerja për mospërmbushje**



Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

- (i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;
- (ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose
- (iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluar, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

### **29.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

29.4

### **Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

## **Neni 30**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

30.1 Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

30.2 Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

## **Neni 31**

### **Përfaqësimi i Palëve**

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.



- a) Personat që do të jenë përgjegjës, në emër të **Autoritetit Kontraktor** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë **Ing. Vullnet Bushaj**, me detyre specialist prane Drejtorise se Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit.

cel/tel/fax

E-mail: [planifikimiterritorit@bashkiashkoder.gov.al](mailto:planifikimiterritorit@bashkiashkoder.gov.al)

- b) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jete **z. Emil Nova**

cel/tel/fax **0682065950**

E-mail: [novatechstudio@gmail.com](mailto:novatechstudio@gmail.com)

- 31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.
- 31.4 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, kreu XIII, neni 107, pika 6, ”Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës”, në përfundim të kontratës, **Ing. Vullnet Bushaj** si personat që do të jenë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.
- 31.5 Personat përgjegjës duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personat përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:
- a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
  - b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
  - c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
  - d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
  - dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
  - e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
  - ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;



f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

### **Neni 31**

#### **Lajmërimet**

- 31.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 31.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

### **Neni 32**

#### **Llogaritja e Afateve**

- 32.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

### **Neni 33**

#### **Vlefshmeria e kontratës**

- 33.1 Kjo kontratë u hartua ne gjashtë kopje origjinale, pese per Autoritetin Kontraktor dhe nje per Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palet
- 33.2 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.



## KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

### Neni 1

#### Dispozitat e Përgjithshme

- 1.1 Blerësi është: **Bashkia Shkodër**  
Adresa: Rr. "13 dhjetori", Nr. 1 Shkodër  
Telefoni: +35522400150  
Numri i faksit: \_\_\_\_\_  
E-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)
- 1.2 Furnizuesi është: "NOVATECH STUDIO sh.p.k"  
Adresa: Njesia bashkiake nr 8, rruga Shenasi Dishnica –Tirane  
E-Mail: [novatechstudio@gmail.com](mailto:novatechstudio@gmail.com)  
Telefon: **0682065950**  
Numri i faksit: \_\_\_\_\_
- 1.3 Gjuha për komunikimet është: **Gjuha shqipe**  
Gjuha është: **Gjuha shqipe**

### Neni 2

#### Sigurimi i Kontratës

- 2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Monedha do të jetë: **Leke**
- 2.3 Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: **Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi mes palëve të procesverbalit perfundimtar të marrjes në dorëzim të shërbimit.**
- 2.4 Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë: **Nuk ka.**

### Neni 3

#### Vendndodhja e Shërbimeve

- 3.1 Shërbimet do të kryhen në vendet sipas përcaktimeve në termat e references.

### Neni 4

#### Fillimi i Zbatimit

- 4.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë nga data e nënshkrimit mes paleve te procesverbalit te fillimit te shërbimit.

### Neni 5





## Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

- 5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat që autoriteti kontraktor i vlerëson si të domosdoshme për përmbushjen e shërbimit nga Kontraktuesi.

### Neni 6

#### Kërkesat e Raportimit

- 6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm:

Të gjitha fazat e projektit duhet të bëhen në konsultim të vazhdueshëm me stafin e Bashkisë Shkodër dhe dorëzimet duhet të bëhen minimalisht sipas etapave:

Etapa 1	Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës I. Analiza e detyrës së projektimit dhe Fazës II Projekt ideja paraprake.	1/4 Afatit(15) dite
Etapa 2	Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës III. Projekt ideja përfundimtare.	1/4 Afatit(15) dite
Etapa 3	Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës IV-VI. Dorëzimi i projekti i zbatimit, konform kritereve për miratimin e lejes së ndërtimit dhe miratimin e oponencës teknike.	2/4 Afatit(30)dite
Etapa 4	Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës VII. Dorëzimi i dokumenteve pranë institucionit përgjegjës për oponencën, dhe miratimi i oponencës teknike.	Në varësi të institucionit përgj.

Dorëzimet duhet të bëhen me shkresë zyrtare, shoqëruar me fletë inventari, pranë Bashkisë Shkodër duke respektuar afatet e sipërpërmendura. Në përfundim të secilës etapë projektuesi ka detyrim të marrë miratimin e Bashkisë Shkodër. Kërkesat apo sugjerimet nga ana e Bashkisë Shkodër duhet të reflektohen sa më parë në materialin e dorëzuar dhe detyrimisht brenda etapës pasardhëse.

Dorëzimet për etapat 1,2 dhe 3 duhet të paraqiten në 2 kopje të printuara dhe në format dixhital. Projekti përfundimtar, pasi të merret miratimi i oponencës teknike, do të dorëzohet në 4 kopje të printuara dhe 2 kopje CD në versionin e dixhitalizuar, ku një CD do të përmbajë punimet në format të përpunueshëm DWG, Office Word-Excel, dhe një CD do të përmbajë të gjithë dokumentacionin në format PDF. I gjithë dokumentacioni që përmbajnë CD sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht, ku secili material PDF të jetë jo me shume se 20mb, sipas kërkesave për pajisje me leje të përcaktuara në bazë të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar), si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar).



## Neni 7

### Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:
- Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
  - Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve.
  - Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve.
  - Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

## Neni 8

### Çmimi i Kontratës

- 8.1 Çmimi i Kontratës është **705,613** (shtatëqind e pesë mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh dhe **846,735.60** (tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë) lekë me tvsh.

## Neni 9

### Kushtet e Pagesës

- 9.1 Pagesa për shërbimin e projektimit referuar VKM nr. 354 dt. 11.05.2016 për "Miratimin Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", neni 15, do të bëhet sipas skedarit të mëposhtëm:
- 30% e vlerës së kontratës për shërbimin, do të paguhet Kontraktuesit brenda 30 diteve nga data e nënshkrimit nga palet të "Procesverbalit të Perkohshëm Marrjes në dorezim të shërbimit" (Ne perfundim të Fazës VI).
  - 30% e vlerës së kontratës për shërbimin, do të paguhet Kontraktuesit brenda 30 diteve nga data e nënshkrimit nga palet të "Procesverbalit Perfundimtar të Marrjes në dorezim të shërbimit" (Pas perfundimit të opionencës teknike dhe reflektimit të ndryshimeve në projekt nga projektuesi do mbahet Procesverbali Perfundimtar I Marrjes në dorezim Faza e VII).
  - Vlera e kontratës së mbetur për tu paguar prej 40% se vlerës totale të kontratës, do të paguhet me kërkesë të kontraktorit pas datës së marrjes në dorezim të punimeve të zbatimit të projektit.
  - Në rast se zbatimi i projektit nga "Autoriteti Kontraktor" nuk fillon brenda një afati kohor prej 365 ditësh nga data e marrjes në dorëzim të projektit, atëherë Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë Kontraktuesit pjesën e mbetur prej 40% të vlerës së kontratës të palikujduar pa prituri zbatimin e projektit.
- 9.2 Pagesa do të bëhet vetëm në rast se është plotësuar dokumentacioni i mëposhtëm:  
Faturen/at tatimore të shërbimit, lëshuar nga Kontraktuesi (1 Original)  
Procesverbalin/et e Marrjes në dorezim të shërbimit (1 Original)
- 9.3 Monedha e pagesës do të jetë: LEKE.



- 9.4 Në zbatim të ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, fatura e lëshuar nga kontraktuesi duhet të jetë elektronike.
- 9.5 Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit.

**Neni 10**  
**Garancia**

- 10.1 Periudha e vlefshmërisë së garancisë do të jetë si më poshtë:  
Siç specifikohet në nenin 2, kushtet e veçanta

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**  
**BASHKIA SHKODËR**

**Kryetar**

**Benet BECI**

**Përfaqësuar me vendim delegimi**

**Zv. Kryetar**

**Orta Bejleri**



**PER OPERATORIN EKONOMIK**  
**NOVATECH STUDIO sh.p.k**

**Administratë Ligjor**

**Emil NOVA**



